

Kushtet e Veçanta për Sigurimin Miks të Jetës - DL021008

Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, dhe këto Kushte të Veçanta për Sigurimin Miks të Jetës, në vazhdim Kushtet e Veçanta, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës të cilin Kontraktuesi i Sigurimit e nënshkruan me Siguruesin.

Neni 2 - Rasti i Siguruar

1. Sipas këtyre Kushteve të Veçanta, kontraktohet sigurimi në rast të vdekjes gjatë kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit, dhe në rast të mbijetimit të kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit.

Neni 3 - Pagesa e Premisë

1. Premia paguhet paraprakisht, sipas afateve të kontraktuara, deri në skadimin e sigurimit. Në rast të vdekjes së Personit të Siguruar, gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, herën e fundit paguhet për muajin kur Personi i Siguruar ka vdekur.

Neni 4 - Obligimet e Siguruesit

1. Nëse Personi i Siguruar mbijeton kohëzgjatjen e kontraktuar të sigurimit, Përfituesit të sigurimit i paguhet shuma e siguruar dhe fitimi i realizuar gjatë kohëzgjatjes së sigurimit.
2. Në rast të vdekjes së Personit të Siguruar gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, Përfituesit të cekur në policë i paguhet:
 - a. 50% nga shuma e siguruar, nëse vdekja ka ndodhur brenda 6 mujorit të parë të kohëzgjatjes së sigurimit
 - b. Shuma e siguruar së bashku me pjesëmarrjen në fitim, nëse vdekja ka ndodhur pas 6 mujorit të parë të kohëzgjatjes së sigurimit
3. Përjashtim nga paragrafi a. i pikës 2. të këtij neni, shuma e siguruar i paguhet tërësisht Përfituesit nëse:
 - a. Kontraktimi i sigurimit është bërë me kontroll paraprake mjekësore
 - b. Vdekja ka ndodhur si pasojë e aksidentit, në kuptim të Kushteve të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale
 - c. Vdekja ka ndodhur si pasojë e shtatzënisë apo gjatë lindjes

4. Me përjashtim nga paragrafi a. i pikës 2. të këtij neni, nëse kontrata për sigurim është nënshkruar në afat prej 30 ditësh nga data e skadimit të sigurimit të mëparshëm me Siguruesin, dhe vdekja nuk ka ndodhur si pasojë e rrethanave të cekura në pikën 3. të këtij neni, atëherë Përfituesit i paguhet 50% e shumës së re të siguruar ose 50% e shumës së siguruar nga sigurimi i mëparshëm, varësisht se cila është më e lartë, por nuk mund të tejkalojë 100% të shumës së re të siguruar.

Neni 5 - Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës

1. Në kontratat për sigurim të nënshkruara me këto Kushte të Veçanta zbatohen nenet e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës.
2. Nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të ndonjërës nga dispozitat e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës dhe ndonjërën nga dispozitat e këtyre Kushteve të Veçanta, në marrëdhëniet nga kontrata për sigurim do të zbatohen dispozitat nga këto Kushte të Veçanta.